

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6567
E enjte, 24 mars 2022
çmimi 0.40 €

Liderët e UÇK-së sot dalin para Gjykatës Speciale



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN MBLEDHJEN E RREGULLT

VITI I PARË I QEVERISJES, KURTI: VIT I KTHESËS DREJT ZHVILLIMIT



Kryeministri Albin Kurti, në mbledhjen e kabinetit qeveritar, fjalimin e ka fokusuar në njëvjetorin e marrjes së mandatit qeverisës. Ai punën njëvjeçare të qeverisë e ka

vlerësuar vit të kthesës drejt zhvillimit. "S'ka dyshim se problemet që kemi trashëguar janë të mëdha e sfidat që i kemi përpara janë edhe më të mëdha. Mirëpo, qytetarët na

kanë besuar që ta bëjmë ndryshimin. Ky ishte vit i kthesës drejt zhvillimit", ka deklaruar Kurti para ministrave, nga të cilët ka kërkuar angazhim edhe më të madh në punë

OPINION

SI DUHET TË AMORTIZOHET PROPAGANDA SERBE

Milazim KRASNIQI



AKTUALE



BIDENI KËRKON SANKSIONE TË REJA DHE NDIHMË PËR UKRAINASIT NË EVROPË

KOMISIONI PËR BUXHET PËRGJYSMON KOMPENSIMET PËR DEPUTETËT

EKONOMI



LUFTA NË UKRAINË NGADALËSON EDHE EKONOMINË E KOSOVËS

SPORT



VOKRRI ELIMINOHET NGA GARA, ADEMI KANDIDATI I VETËM PËR KRYETAR TË FFK-së

Quint-i i zhgënjyer me vendimin e Kosovës për moslejimin e zgjedhjeve të Serbisë



KOSOVA PLOTËSOI VETËM GJYSMËN E OBJEKTIVAVE TË PLANIT PËR ZBATIMIN E MSA-së

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Bideni kërkon sanksione të reja dhe ndihmë për ukrainasit në Evropë

Ukraina kërkon armë për t'u mbrojtur nga Rusia

KIEV, 23 MARS - Ukraina ka përsëritur thirrjen ndaj liderëve perëndimorë për ta furnizuar Kievin me armë të avancuara për t'i luftuar trupat e Rusisë. "Forcat tona të armatosura po mbahen me një kurajë përtej njerëzore, por ne nuk mund ta fitojmë luftën pa armë mbrojtëse. Në rastin tonë është mbrojtje, jo agresion", ka thënë këshilltari presidencial ukrainas Andriy Yermak.

Apeli vjen menjëherë pasi Rusia njoftoi se kishte vendosur raketa hipersonike në fushën e betejës, afër kufirit të Ukrainës me anëtarin e NATO-s, Rumaninë, në atë që analistët thanë se ishte përdorimi i parë i armëve të tilla në botë.

Yermak tha se ishte "e pamundur" që Ukraina të mbrohej efektivisht pa një "sistem të besueshëm të mbrojtjes ajrore që rrezon armikun dhe raketat balistike nga

një distancë e madhe".

Bideni dhe udhëheqës të tjerë të NATO-s kanë rritur mbështetjen ushtarake për Ukrainën, duke përfshirë armët antitank që kanë ndihmuar në bllokimin e forcave ruse.

Apeli i Ukrainës për mbështetje më të madhe ushtarake nga aleatët perëndimorë ka qenë një refren kyç në një valë të fjalimeve të fundit të presidentit, Volodymyr Zelensky, drejtuar ligjvënësve evropianë dhe perëndimorë.

Zelensky do t'u drejtohet ligjvënësve japonezë dhe francezë të mërkurën dhe një samit të posaçëm të NATO-s të enjten. Udhëheqësi i Ukrainës së fundmi pranoi se Kievi nuk kishte gjasa të bëhej anëtar i bllokut. "Ata nuk duan të na shohin në NATO. Kjo frikë nga përshkallëzimi është e kuptueshme, por kjo nuk do të na shpëtojë", ka shtuar Yermak në fjalimin e tij.



WASHINGTON, 23 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, do të mblidhet me aleatët kryesorë në Bruksel dhe Varshavë këtë javë, derisa liderët përpiqen të parandalojnë që lufta e Rusisë kundër Ukrainës të kalojë në një katastrofë edhe më të madhe. Biden ka frikë se Rusia mund të përdorë armë kimike ose bërthamore derisa pushtimi i saj ngecën përballë problemeve logjistike dhe një rezistence të ashpër ukrainase. Sfidat humanitare po rriten, gjithashtu. Miliona refugjatë janë larguar nga luftimet, kryesisht duke kaluar kufirin në Poloni dhe lufta ka rrezikuar të korrat e grurit dhe elbit të Ukrainës, duke rritur

mundësinë e rritjes së urisë në zonat e varfra anembanë globit. Jake Sullivan, këshilltar i Bidenit për Sigurinë Kombëtare, tha se presidenti do të koordinohet me aleatët për ndihmën ushtarake për Ukrainën dhe sanksionet e reja ndaj Rusisë. Ai shtoi se Bideni po punon në përpjekjet afatgjata për ta rritur mbrojtjen në Evropën Lindore, ku më shumë vende kanë frikë nga agresioni rus. Presidenti po synon, gjithashtu, ta zvogëlojë varësinë e kontinentit nga energjia ruse. "Kjo luftë nuk do të përfundojë lehtë ose shpejt", u tha Sullivan gazetarëve në një konferencë në Shtëpinë e Bardhë të martën. Sullivan theksoi se referencat e

presidentit rus Vladimir Putin, për armët bërthamore në fillim të konfliktit, janë "diçka për të cilën ne duhet të shqetësohemi", duke shtuar se Bideni do të fliste me aleatët për "përgjigje të mundshme" nëse udhëheqësi rus e ndërmerri atë hap.

Bideni do të marrë pjesë, gjithashtu, në takimet e Bashkimit Evropian dhe G7-s, i cili përfshin demokracitë më të pasura në botë.

Më pas ai do të udhëtojë në Varshavë, të premtën, ku me zyrtarët polakë pritet të diskutojë mbi krizën e refugjatëve ukrainas. Bideni është planifikuar të takohet me presidentin polak Andrzej Duda të shtunën.



Hetuesit ende nuk e dinë shkakun e rrëzimit të aeroplanit në Kinë

WUZHOU, 23 MARS - Shiu që po bie ka shtuar sfidat, me të cilat përballen hetuesit kinezë, duke u përpjekur të gjejnë pse një avion pasagjerësh me 132 persona në bord u rrëzua në një rajon të largët pyjor këtë javë.

Kërkimi për kutitë e zeza (pajisje brenda avionit që regjistrojnë të dhënat e fluturimit) dhe ndonjë të mbijetuar eventual, u pezullua përkohësisht të mërkurën, më 23 mars, për shkak të shiut në malin me baltë.

Aeroplani i kompanisë "China Eastern Airlines" po fluturonte në lartësinë 8 800 metra të hënën pasdite kur papritur ra në një hendek në malet jashtë

qytetit jugor kinez të Wuzhou. Ekipet e shpëtimit me qen dhe dronë kanë gjetur kuletat, karta identiteti dhe pjesë të vogla të mbetjeve të avionit. Autoritetet nuk kanë dhënë asnjë indikacion se kanë gjetur të mbijetuar apo trupa njerëzish. Pjesë të avionit janë të shpërndara në një zonë të gjerë, duke përfshirë anën tjetër të malit, ka njoftuar transmetuesi shtetëror CCTV.

Rikuperimi i të ashtuquajturave kuti të zeza është çelësi i hetimit - ato zakonisht janë lyer me ngjyrë portokalli për dukshmëri, por emërtimi "e zeze" ka mbetur prej kohësh. Një pajisje, që regjistron të

dhënat e fluturimit, kap informacion në lidhje me shpejtësinë e avionit, lartësinë, drejtimin lart ose poshtë, veprimet e pilotit dhe performancën e të gjitha sistemeve kryesore. Regjistruesi i zërit të kabinës kap tingujt duke përfshirë bisedat dhe zhurmën e motorit në sfond gjatë fluturimit.

Edhe me shkallën e dëmtimit të avionit hetuesit duhet të jenë në gjendje të kenë një ide të mirë se çfarë ndodhi nëse kutitë e zeza mbijetuan dhe mund të shkarkohen. "Gjendja teknike e aeroplanit gjashtë vjeç e gjysmë ishte e qëndrueshme" dhe plotësonte kërkesat për të



fluturuar, ka njoftuar Sun Shiyang, kryetari i degës provinciale Yunnan të kompanisë së fluturimit.

Fluturimi ishte nisur nga qyteti i Kunmingut në Yunnan për në Guangzhou në provincën Guangdong.

SI DUHET TË AMORTIZOHET PROPAGANDA SERBE



Milazim KRASNIQI

Lidhur me mbajtjen/mosmbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, qeveria e Kosovës po e humb betejën propagandistike e politike. Madje edhe BE, me zërin e Peter Stanos dje e akuzoi Kosovën dhe e lavdëroi Serbinë. Vuçiqi ka vajtuar dje tërë ditën dhe ka dalë si gjoja njeri që po e mbron paqen e stabilitetin, të cilat po i rrezikon Kurti dhe qeveria e tij. Kryetari i

komunës së Shtërpçës, Dalibor Jevtiqi, ka deklaruar dje në Beograd se gjendja në Kosovë nuk ka qenë "kurrë më e rëndë".

Ndaj tërë kësaj kanonade propagandistike e politike, qeveria e Kosovës ka heshtë, po të mos llogaritet belbëzimi i Besnik Bislimit. Ndërsa është dashhtë të flitet tërë kohën për këtë problem, nga kryeministri, nga presidentja, nga ministria e jashtme, nga zëdhënësit e ndryshëm, nga i madh e i vogël, që të amortizohej disi kjo fushatë e egër.

Por, çka duhet të thonë këta njerëz të qeverisë sonë? Ja disa udhëzime për ta:

1. Zgjedhjet e Serbisë përveç se janë shkelje e Kushtetutës, paraqesin rrezik për sigurinë, në kontekstin e zhvillimeve në Ukrainë e në Ballkan. Serbia synon t'i përdorë ato zgjedhje

për ndërhyrje në Kosovë, për destabilizimin e Kosovës, që t'i lehtësohet presioni Putinit, duke hapur një vatër krize në zonën e kontrolluar nga NATO.

2. Serbia si i vetmi shtet në Evropë që nuk pranon të vendos sanksione ndaj Rusisë, nuk është model i shtetit që mban zgjedhje të lira e të ndershme, po në vazhdimësi manipulohen zgjedhjet, gjë që është konstatuar edhe nga institucionet kredibile të BE-së. Posaçërisht votat nga Kosova shfrytëzohen për manipulime me rezultatin zgjedhor dhe për stimulimin e nacionalizmit në Serbi.

3. Serbët e Kosovës kanë status të privilegjuar në shtetin e Kosovës sepse ata i kanë vendet e rezervuara në Kuvend dhe në qeveri.

5. Gjuha serbe është gjuhë

zyrtare në tërë Kosovën.

6. Sistemi arsimor për serbët në Kosovë është i njëjtë si sistemi i arsimit që zbatohet në Serbi.

7. Kisha Ortodokse Serbe ushtron mandatin në tërë territorin e Kosovës pa asnjë pengesë, pa asnjë kufizim, që do të mund të kishte me ndonjë Marrëveshje Themeltare me shtetin.

8. Serbët e Kosovës në pjesën veriore janë të rebeluar ndaj pagesës së energjisë elektrike, të cilën ua paguajnë institucionet shtetërore të Kosovës.

9. Në shumë komuna të Kosovës ende mbahet sistemi paralel i pushteteve komunale, gjë të cilën qeveritë e Kosovës e kanë toleruar në emër të vullnetit të mirë për dialog e marrëveshje, të cilin Serbia e ka keqpërdorur në vazhdimësi.

Pra, pozita e serbëve në Kosovë është thjesht e privilegjuar dhe e thyen edhe plafonin që ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligjet. Por, kjo tolerancë aplikohet për të dhënë provën se Kosova e synon një marrëveshje finale me Serbinë dhe e luan rolin e faktorit stabilizues në Ballkan. Mirëpo, tentativa që të organizohen fushata zgjedhore dhe zgjedhje serbe në Kosovë, nuk është vetëm thyerje e plafonit të Kushtetutës e të ligjeve, po rrezikon sigurinë në rrethanat aktuale, kur Serbia është pozicionuar si aleate e Rusisë. Pra, në këto linja duhet të zhvillohet kundërvënja propagandistike e politike e institucioneve tona ndaj fushatës së egër të Serbisë po edhe ndaj keqkuptimit nga ana e Bashkimit Evropian.

Kosova plotësoi vetëm gjysmën e objektivave të planit për zbatimin e MSA-së

Të gjeturat e monitorimit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) për implementimin e Planit Kombëtar për Zbatim të MSA-së (PKZMSA) për vitin 2021 tregojnë se nga gjithsej 245 veprime, institucionet përgjegjëse të Kosovës kanë arritur të përmbushin plotësisht vetëm 119 veprime, apo rreth 49 për qind të totalit të paraparë për vitin që lamë pas. Pjesët e tjera mbesin ende të papërmbushura ose në proces, rrjedhimisht janë bartur për vitin 2022

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 MARS - Duke pasur parasysh rëndësinë që ka MSA-ja në rrugën drejt BE-së si dhe në zhvillimin e vendit, Grupi për Studime Juridike dhe Politike vazhdon ta monitorojë punën e institucioneve të Kosovës në përmbushjen e Planit Kombëtar për Zbatim të MSA-së (PKZMSA) që nga fillimi i hyrjes në fuqi. PKZMSA 2021-2025 u miratua nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2021 dhe shënon planin e gjashtë që prej vitit 2015 kur u nënshkrua MSA-ja. Ngjashëm sikurse vitet e kaluara, GLPS-ja ka bërë një vlerësim të implementimit të PKZMSA-së për vitin 2021 në tërësi. Për ta realizuar këtë vlerësim, GLPS-ja ka kërkuar informata nga të gjitha institucionet përgjegjëse në lidhje me punën e tyre duke vlerësuar se sa kanë arritur t'i përmbushin objektivat e paracaktuara. Në të njëjtën kohë ka vlerësuar afatet kohore të zbatimit dhe sa të kujdesshëm ishin në procesin e përafërmit të akteve ligjore të Kosovës me korpusin e të drejtës së BE-së, Acquin.

Të gjeturat e monitorimit të GLPS-së për implementimin e

PKZMSA-së për vitin 2021 tregojnë se nga gjithsej 245 veprime,

institucionet përgjegjëse kanë arritur të përmbushin plotësisht vetëm 119 veprime, apo rreth 49 për qind të totalit të paraparë për vitin që lamë pas. Pjesët e tjera mbesin ende të papërmbushura ose në proces, rrjedhimisht janë bartur për vitin 2022.

Brenda PKZMSA-së masat ndahen në ato legjislative dhe zbatuese.

Të dhënat nga vlerësimi i realizuar tregojnë se nga gjithsej 111 masa legjislative, vetëm 45 për qind janë përmbushur, kurse nga 134 masa zbatuese, 51 për qind rezultojnë të plotësuara.

Nga vlerësimi i GLPS-së posaçërisht mund të nxirren përfundimet e dhëna se: Në shumë raste institucionet e Kosovës nuk kanë arritur që të hartojnë në kohë, apo nuk kanë filluar që të hartojnë ligjet që janë parashikuar që të miratohen gjatë vitit 2021; Një numër i madh i institucioneve nuk kanë arritur që ta hartojnë legjislacionin sekondar, edhe në ato raste kur ligjet ka vite që ishin miratuar dhe janë në fuqi; Në të njëjtën kohë, vlerësimi tregon që institucionet përgjegjëse janë të prira të



dështojnë të realizojnë ato objektiva arritja e cilave varet nga puna ndërinstitucionale dhe planifikimi afatgjatë; Disa masa (p. sh: Rregullorja e Re e Kuvendit, Ligji për Arsimin e Lartë, Projektligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç etj.) barten nga viti në vit dhe karakterizohen me vonesa të shpeshta dhe stagnime gjatë procedurave; Disa institucione mospërmbushjen e masave të parapara ia kanë atribuuar situatës epidemiologjike në Kosovë; Në disa raste projektligjet janë kthyer në rishikim për shkak të mosharmonizimit me Aquis, sikurse është rasti me projektligjin për Prokurim Publik; Në fushën e

Administratës Publike mbeten një sërë projektligjesh të pamiratuara, por shumë të rëndësishme dhe prioritare, siç janë Projektligji për Paga, Projektligji për Zyrarët Publikë dhe Projektligji për Valën e Dytë të Racionalizimit të Agjencive të Pavarura.

Marrë parasysh këto rezultate, GLPS-ja kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta përmirësojë kontrollin e performancës së institucioneve nën menaxhimin e saj dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, duke kërkuar nga këto të fundit që jo vetëm të raportojnë, por edhe t'i plotësojnë objektivat në kuadër të këtij procesi.

Po sipas GLPS-së, duhet filluar një proces të ri të priorizimit të

objektivave që duhen arritur. GLPS-ja ka theksuar se suksesi i institucioneve në fund matet nga aftësia e tyre për të përmbushur objektiva më të rëndësishme, siç janë pakoja e ligjeve për reformë të administratës publike dhe Ligji për Arsimin e Lartë.

Të mërkurën edhe kabineti qeveritar ka diskutuar për Zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2021-2025. "Programi në vitin 2021 është zbatuar në nivel prej 51.43-përqindësh; 126 nga 245 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 48.57 për qind të tyre nuk janë zbatuar ose 119 masa nuk janë zbatuar", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN MBLEDHJEN E SAJ TË RREGULLT

Viti i parë i qeverisjes, Kurti: Ishte vit i kthesës drejt zhvillimit

Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e kabinetit qeveritar, fjalimin e ka fokusuar në njëvjetorin e marrjes së mandatit qeverisës. Ai punën njëvjeçare të qeverisë e ka vlerësuar vit të kthesës drejt zhvillimit. “S’ka dyshim se problemet që kemi trashëguar janë të mëdha e sfidat që i kemi përpara janë edhe më të mëdha. Mirëpo, qytetarët na kanë besuar ta bëjmë ndryshimin. E ky ishte vit i kthesës drejt zhvillimit”, ka deklaruar Kurti para ministrave, nga të cilët ka kërkuar angazhim edhe më të madh në punë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Qeveria e Kosovës të mërkurën ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën janë miratuar në total 28 vendime, prej të cilave katër projektligje, dy udhëzime administrative, shtatë nisma për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dy raporte. Kryeministri Albin Kurti në këtë mbledhje fjalimin e ka fokusuar në njëvjetorin e marrjes së mandatit qeverisës. “Sot bëhet një vit prej se qytetarët me pjesëmarrjen e tyre masive në zgjedhje dhe votën e tyre plebishitare i patën zgjedhur qeverinë dhe institucionet e reja, me ç’rast, përfaqësimi në këtë orë, saktësisht para një viti, më 22 mars 2021, ne morëm detyrën e re”, u ka thënë Kurti ministrave në mbledhjen e qeverisë. Sipas tij, qytetarët votuan para një viti

për riorientimin demokratik dhe evropian të shoqërisë sonë, votuan për luftën ndaj korrupsionit institucional dhe financiar, votuan për rikthimin e virtyeteve në institucione që shpërndajnë barazi dhe drejtësi, votuan për kthimin e aftësisë në bordet që administrojnë burimet ekonomike dhe njerëzore, votuan për rritjen e punësimit dhe shpërndarjen me të drejtë të punës sipas aftësive dhe kualifikimit, votuan për forcimin e ushtrisë dhe, sipas tij, votuan për rritjen e ekonomisë së buxhetit e të forcimit të shtetit e sovranitetit.

Kryeministri ka thënë se gjatë një viti të punës ky kabinet qeveritar ka marrë 581 vendime. “Sot i tejkalojmë 600 sosh, ku proceduam 128 projektligje, ku sot i kalojmë edhe 130, më shumë sesa çdo qeveri tjetër paraprake në vitin e parë të saj. Përgjatë një viti kemi naviguar

nëpër kriza botërore, të cilat kanë testuar jo vetëm aftësinë tonë qeverisëse, por edhe qëndrueshmërinë tonë shoqërore. Së bashku kemi menaxhuar pandeminë Covid-19 me masa, të cilat kanë ruajtur edhe shëndetin publik të qytetarëve edhe shëndetin e ekonomisë sonë publike e private, duke e shënuar numrin më të ulët të vdekjeve në rajon e numrin më të lartë të vaksinimit. Së bashku kemi përmbushur zotimin, që brenda vitit të vaksinohemi mbi 60 për qind të popullsisë së vaksinueshme dhe sot kemi hapur ekonominë, jetën shoqërore dhe ngjarjet kulturore dhe sportive që na kanë munguar shumë gjatë”, deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se krahas pandemisë kishin edhe krizën e energjisë, e cila, sipas tij, ende s’ka kaluar. “Së bashku kemi marrë masat emergjente duke subvencionuar koston shtesë në mënyrë që kriza të mos i rëndojë ata që fitojnë më së paku”, është shprehur Kurti. Ai ka thënë se problemet që kanë trashëguar janë të mëdha, megjithatë u ka bërë thirrje për punë ministrave. “S’ka dyshim se problemet që kemi trashëguar janë të mëdha e sfidat që i kemi përpara janë edhe më të mëdha. Mirëpo, qytetarët na kanë besuar ta

bëjmë ndryshimin. Ky ishte vit i kthesës drejt zhvillimit”, ka deklaruar Kurti.

Kryeministri Kurti ka thënë se ky vit i qeverisjes ishte vit i zhvillimit ekonomik dhe i investimeve. “Ishte vit i reformave në drejtësi, vit i luftimit të krimit dhe korrupsionit dhe vit i kursimit edhe i mirëmenaxhimit. Viti i parë i qeverisjes sonë ishte edhe vit i departizimit dhe rimëkëmbjes së ndërmarrjeve publike dhe mbrojtjes së pasurisë së Kosovës. Po ashtu, ishte edhe vit i investimit në arsim dhe në bujqësi”, ka deklaruar ai, duke theksuar më tutje se ishte edhe një vit i reformimit të diplomacisë. “Ishte vit i investimeve në mbrojtje dhe në ushtrinë e Kosovës. Është rritur buxheti për ushtrinë në vlerë prej 100 milionë eurosh. Janë rritur kapacitetet operacionale dhe profesionale të FSK-së”, ka theksuar kryeministri Kurti.

Ai u është drejtuar edhe me një mesazh ministrave. “Pra, të nderuar anëtarë të kabinetit qeverisës, këto janë vetëm disa nga veprimet e shumta të cilat e kanë bërë kthesën e madhe drejt zhvillimit, drejt drejtësisë në vitin e parë qeverisës. Punët i kemi bërë në dritën e diellit, pa asnjë skandal, me transparencë e llogaridhënie të paparë

ndonjëherë në 20 vjetët e fundit. Andaj unë ju falënderoj të gjithë dhe ekipet në ministrinë përkatëse për këtë rezultat shembullor në vitin e parë të qeverisjes sonë. Pra nevojitet edhe një vit tjetër që të mbërrijmë në gjysmë të mandatit, andaj kemi shumë punë në këtë vit, në përputhje me atë punëtorinë që e kemi zhvilluar në fillim të vitit. Por nuk ka dyshim që me vullnetin që kemi, me dijen që kemi, me përvojën që kemi fituar, nuk ka sfida të cilat nuk do t’i kalojmë së bashku për hir të popullit, shtetit e kombit tonë”, ka thënë kryeministri Kurti.

Një ditë më parë tre liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, ia kanë numëruar Albin Kurtit dështimet për një vit qeverisjeje të vendit. Liderët opozitarë kanë thënë se kjo qeveri është treguar e paafte në të gjithë sektorët. Sipas tyre, kjo qeveri ka dështuar në ekonomi, në arsim, në politikën e brendshme dhe në atë të jashtme. Ata e kanë kritikuar qeverinë Kurti edhe për menaxhimin e keq të pandemisë.

Më 22 mars të vitit të kaluar me 67 vota për, 30 kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi i Kosovës pati zgjedhur qeverinë e re, të udhëhequr nga Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Quint-i i zhgënjyer me vendimin e Kosovës për moslejimin e zgjedhjeve të Serbisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MARS - Shtetet e Quint-it kanë shprehur "zhgënjim të madh" me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë të caktuara më 3 prill.

Vendet e Quint-it janë: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Italia, Gjermania dhe Franca. "Përderisa ne e vlerësojmë qasjen e Serbisë për të gjetur zgjidhje, me zhgënjim të madh ne shohin vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta refuzuar propozimin konstruktiv të prezantuar nga Quint-i", thuhet në deklaratë.

Me këtë vendim "Qeveria e Kosovës ka dështuar ta demonstrojë përkushtimin për parimin e mbrojtjes së të drejtave civile dhe politike për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe anëtarët e grupeve të minoriteteve".

Sipas Quint-it, "kjo sjellje e Qeverisë së Kosovës nuk është në linjë me vlerat dhe parimet tona dhe do t'i minojë aspiratat e saj evropiane".

Ky reagim pasoi refuzimin nga ana e Qeverisë së Kosovës që ta lejojë mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë më 3 prill në territorin e saj, pa një kërkesë apo marrëveshje të drejtpërdrejtë në mes të Kosovës



dhe Serbisë.

Në deklaratën e Quint-it mirëpritet vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'i vendosur sanksione Rusisë për shkak të pushtimit në Ukrainë, duke ndjekur shembullin e BE-së, por edhe të ShBA-së. "Megjithatë, nga Kosova pritet që t'i respektojë vlerat thelbësore dhe përgjegjësitë ndaj stabilitetit rajonal dhe t'i respektojë proceset demokratike, por edhe të zotohet për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të grupeve minoritare", ka theksuar Quint-i.

Quint-i, po ashtu, i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të përmbahen

nga çdo veprim dhe retorikë që mund t'i rrisë tensionet dhe mund të çojë në incidente. "Ne presim nga Qeveria e Kosovës që të veprojnë në interes të të gjithë qytetarëve të saj, të punojnë në uljen e tensioneve dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Ky proces është kritik për arritjen e përparimit drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizim, që përfundimisht do ta zhbllokonte perspektivën evropiane të Kosovës", ka deklaruar

Quint-i.

Kosova ka kërkuar që Qeveria e Serbisë t'i dërgojë kërkesë ekzekutiv të kosovar për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare serbe.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se me këtë kërkesë Kosova ka kërkuar që Serbia ta njohë pavarësinë e saj. "Serbia nuk mund ta pranonte këtë dhe Serbia nuk do ta pranojë këtë", ka deklaruar Vuçiqi në një konferencë për medie më 22 mars. Ai ka thënë se serbët e Kosovës do të votojnë në vendvotimet në komunat në Serbinë qendrore.

Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ka kërkuar që të ketë marrëveshje mes dy qeverive për mbajtjen e zgjedhjeve. "Unë kurrë nuk kam synuar që nëpërmes këtij letërkëmbimi ta sjell njohjen e Serbisë. Unë e kam ditur që kjo nuk bëhet, mirëpo nuk mund të kërkojë askush prej meje që unë të mos e njoh Republikën e Kosovës, pavarësinë e vendit tonë", ka thënë Kurti në një intervistë për transmetuesin publik të Kosovës.

Të martën Kurti ka thënë se ka kërkuar që Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. "Nuk do të thosha që qeveria ka marrë vendim për mosmbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, por e vërteta është se nuk ka marrëveshje paraprake, natyrisht që paraqet kushtin për mbajtjen e atyre zgjedhjeve, e i cili kusht nuk është plotësuar. Ne kemi pritur shkëmbim normal të letrave të kërkesës së tyre, të trajtimit tonë, por kjo nuk ka ndodhur", ka deklaruar Kurti.

Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë vazhdimisht thirrje Qeverisë së Kosovës që të gjejë mënyra për mbajtjen e zgjedhjeve serbe. Zgjedhjet e fundit parlamentare, që Serbia i ka organizuar edhe për komunitetin serb në Kosovë, kanë qenë ato të 21 qershorit 2020.

Komisioni për buxhet përgjysmon kompensimet për deputetët

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka miratuar propozimin e shefes së grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetëve.

Në mbledhjen e këtij komisioni është propozuar që vendimi i datës 10 tetor 2011 të ndryshohet si vijon: Për shpenzimet ditore të deputetëve ndahen 5 euro në ditë

për pjesëmarrje në seanca plenare dhe mbledhje të komisionit; Kompensimi për shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrje në punimet e seancës plenare dhe komisione, caktohet si vijon: deri në 30 km 5 euro, deri në 60 km 10 euro dhe mbi 60 km 15 euro.

Shpenzimet maksimale që një deputeti mund t'i mbulohe brenda një muaji janë 150 euro. Deputetët duhet ta deklarojnë vendbanimin primar dhe sekondar nëse kanë në

Administratën e Kuvendit, ndërsa lista e deputetëve që udhëtojnë dërgohen nga kryetarët e grupeve parlamentare në administratën e Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Armend Muja, ka thënë se propozimi i grupit parlamentar të LV-së është i arsyeshëm dhe ka një tavan të shpenzimeve deri në 150 euro. Përveç deputetëve të pozitës, pro këtij vendimi ishin deputeti nga LDK-ja, Avdullah Hoti dhe deputetja Duda Balje. Kurse në

votim nuk morën pjesë deputeti nga PDK-ja, Mërgim Lushtaku dhe deputeti nga AAK-ja, Pal Lekaj.

Madje deputeti Pal Lekaj ka propozuar heqjen e të gjitha shpenzimeve të udhëtimit të deputetëve. Ky propozim do t'i dërgohet edhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Deri më tani kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit të deputetëve është bërë në bazë të vendimit të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-

V-079, të datës 10 tetor 2011, i nxjerrë në bazë të nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Deputeti kompensohet për shpenzimet e udhëtimit si në vijim: deri në 30 km - 10 euro, deri në 60 km - 20 euro dhe mbi 60 km - 30 euro, për pjesëmarrje në punimet e seancës plenare dhe në komisione. Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit nuk nënkupton shpenzimet për derivate, por për të gjitha mënyrat e udhëtimit.

Digjen dhjetëra hektarë pyje në Malishevë

MALISHEVË, 22 MARS (ER) - Malet në mes të fshatrave Gurbardh dhe Turjakë të Malishevës janë përfshirë nga zjarri dhe janë djegur dhjetëra hektarë. Zjarre janë regjistruar edhe në disa vende të tjera, ndërsa ekipet e zjarrfikësve dhe shpëtimin kanë intervenuar për shuarjen e tyre.

Për këto zjarre ka reaguar edhe kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, i cili u ka bërë thirrje qytetarëve të bëjnë kujdes. Po ashtu, zjarre janë regjistruar edhe në malet në mes të fshatrave Guriq dhe Pagarushë, pastaj në Panorç, si dhe një shtëpi e pabanuar në

fshatin Shkozë. Ekipet e zjarrfikësve dhe të shpëtimin janë angazhuar për shuarjen e zjarrit.

Po në vendngjarje kanë qenë edhe ekipet e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, ndërsa zjarrfikësit janë ndihmuar edhe nga banorët.



Latifi nënshkruan kontratat për shpërndarjen e mekanizmit bujqësor



RAHOVEC, 23 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga nënkryetari Fatmir Iska dhe drejtori i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Berat Duraku, kanë nënshkruar kontratat për shpërndarjen e mekanizmit bujqësor në vlerë 786 915 euro.

Latifi të mërkurën ka nënshkruar kontratat për shpërndarjen e mekanizmit bujqësor në vlerë 789 915 euro për sektorët: Vreshtari,

pemëtari, perimtari, blegtori dhe bletari. "Njoftohen bujqit e fermerët rahovecas, se paraprakisht do të shpërndahen pajisjet e mbetura nga thirrja e kaluar, për ta vazhduar shpërndarjen e pajisjeve nga thirrja e fundit për aplikim. Lutem të gjithë fermerët, që për informata shtesë, lidhur me kohën dhe vendin e shpërndarjes, t'i drejtohen Drejtorisë për Bujqësi në komunën e Rahovecit. Po ashtu, falënderojmë të gjithë

fermerët e komunës sonë për durimin dhe mirëkuptimin për vonesën madhe në shpërndarjen e mekanizmit bujqësor, i shkaktuar si pasojë e stërzgjatjes së procedurave të prokurimit publik. Komuna e Rahovecit në qendër të programit qeverisës e ka bujqësinë. Do të jemi gjithmonë pranë bujqve, duke i përkrahur konkretisht dhe me të gjithë potencialin tonë institucional, ekonomik dhe profesional", ka thënë Latifi.

Përvjetori i 'Epopesë së Dukagjinit', Gjini nderon dëshmorët në fshatin Shqiponjë

GJAKOVË, 23 MARS (ER) - Në prag të përvjetorit të Epopesë së Dukagjinit, kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, me bashkëpunëtorë, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Shqiponjë. "Sot bëmë homazhe në Shqiponjë, në një nga fshatrat më emblematike të zonës së Dukagjinit. Ky vend ka dhënë shumë luftëtarë të zotë,

dëshmorë dhe heronj. Nesër do të jemi bashkë në manifestimin qendror në Glogjan, aty ku ka nisur Epopeja e Dukagjinit", ka thënë Gjini.

Më 24 mars 1998 në Glogjan është zhvilluar beteja frontale mes forcave të UÇK-së dhe forcave të armikut të cilat e kishin rrethuar Glogjanin, ndërsa synim kishin shtëpinë e familjes Haradinaj, por kanë hasur në rezistencë të fuqishme.



Përkujtohet heroi Asllan Fazliu në 23-vjetorin e rënies

DRENAS, 23 MARS (ER) - Me rastin e 23-vjetorit të rënies së heroit Asllan Fazliu, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, bashkë me kryetarin e komunës së Skenderajt, Fadil Nura, familjarë dhe bashkëluftëtarë të heroit, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë, kanë

bërë homazhe pranë varrit të heroit Asllan Fazliu në varrezat e dëshmorëve në fshatin Gllanasellë.

Kryetari Lladrovci ka vlerësuar lart veprën dhe sakrificën e heroit Asllan Fazliu. "Sot në 23-vjetorin e rënies kujtojmë dhe nderojmë sakrificën dhe heroizmin e atdhetarit të shquar, heroit të kombit

Asllan Fazliu, njërit nga ushtarët e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kam pasur fatin të njoh edhe si mik, shok të shkollës e ilegales, jeta dhe vepra e të cilit lidhet me ngushtë me historinë e shumë bashkëluftëtarëve tanë që dhanë jetën për lirinë e vendit", ka thënë Lladrovci.

Gjatë vitit 2021 në spitalin e Ferizajt janë kryer mbi 1 000 operacione

Ferizaj, 23 mars (ER) - Në sallat e operacionit të Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt, kirurgë, të asistuar nga anesteziologë dhe

pjesa tjetër e ekipit operator, kanë kryer 1 085 operacione vitin e kaluar. Gjatë vitit 2021 në këtë spital kishte 1 590 lindje,

prej tyre 254 me operacion. Sipas raportit vjetor të punës, u realizuan, gjithashtu, 18 726 vizita ambulatore dhe 12 116

dializa. Kurse në laboratorin e spitalit u regjistruan 121 212 analiza për 19 796 pacientë brenda periudhës janar-dhjetor.



Liderët e UÇK-së sot dalin para Gjykatës Speciale



Prishtinë, 23 mars - Konferenca e njëmbëdhjetë për ecurinë e çështjes në rastin kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit do të mbahet sot (e enjte). Lajmi është dhënë në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, ku është thënë se konferenca do të nisë në orën 14:30.

Në konferencën e 22 shkurtit është zhvilluar një debat i ashpër në mes të mbrojtjes së ish-drejtuësve të UÇK-së dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në lidhje me dëshmitarët. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, kishte thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai pati deklaruar se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. "Nuk ka barazi të palëve. Flasim për një gjykatë që është e Kosovës dhe dispozitat që duhet të ndiqen. Kjo është shumë e qartë në kuadrin e kësaj gjykatë.

Procesi gjyqësor kërkon që mbrojtja të përfshihet në të gjithë gamën e shërbimeve. Pra, mbrojtja duhet të sigurojë pa kufizime mbrojtjen e një personi, mbrojtjen e provave dhe përgatitjen për marrjen në pyetje. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se marrja në pyetje duhet të bëhet pa kufizime, ndërsa ndryshe vepron Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), kishte thënë Keohe.

Më tutje, ai kishte thënë se 157 dëshmitarë të ZPS-së kanë masa mbrojtëse. "Dëshmitarët në listën e dëshmitarëve nuk janë dëshmitarë në listën e ZPS-së. Pikë. Janë dëshmitarë që duhen marrë në pyetje nga të gjitha palët. Kjo është një shtesë paligjshmërie. Kemi 326 dëshmitarë, pothuajse 50 për qind kanë masa mbrojtëse. Pra 157 dëshmitarë nga 326 kanë masa të tilla", kishte deklaruar ai. Avokati i Thaçit kishte thënë se absurditeti qëndron në faktin se ZPS-ja ka kërkuar masa mbrojtëse edhe për zyrtarë qeveritarë, ndërkombëtarë, si dhe oficerë

ushtarakë. "Janë nën masat mbrojtëse të ZPS-së. Kam lexuar dëshminë e një dëshmitari që përfaqësohej nga një avokat i zoti në Britani. Pra, nga të gjithë këta persona, ZPS-ja po dëshiron ta përjashtojë mbrojtjen që të bëjë intervistimin e tyre. ZPS-ja thotë se kërkon që ta shmangë ritraumatizimin e viktimave. A po e thotë me seriozitet ZPS-ja se edhe gjeneralëve duhet t'ua mbrojtje anën psikologjike? Sigurisht që jo", pati deklaruar avokati i Thaçit.

Ndërsa avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, kishte hedhur akuzë të rënda ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Gjykatën Speciale në lidhje me protokollin e propozuar nga kjo zyrë për kontaktet me dëshmitarët. Emmersoni pati deklaruar se pretendimet e ZPS-së për ndërhyrje të mundshme të mbrojtjes të dëshmitarët janë qesharake dhe fyese. "Janë komente fyese. Nuk përputhen fare me rregullat dhe dua ta trajtoj sepse është koment serioz. Ju

duhet ta shikoni mënyrën se si paraqitet çështja te prezumimi i pafajësisë. Çështja kryesore është proporcionaliteti i kësaj që propozohet. Prokurori tha që nuk e dinte nëse e kishte të drejtën t'i përfaqësonte viktimat. Ai nuk e ka këtë të drejtë. Siç thotë prokuroria se për çfarë është ky protokoll dhe cila është metodologjia? Prokuroria thotë se do ta shmangë ritraumatizimin e dëshmitarëve dhe ta ruajë integritetin e tyre fizik", ka thënë ai. Ai pati kërkuar që të përjashtohet nga procesi gjyqësor çdo person i cili nuk është viktimë. Më tutje, avokati i Veselit kishte thënë se ZPS-ja ka orkestruar takime me ambasadorët evropianë për çështjen e të akuzuarve dhe, sipas tij, kjo është diçka shokuuese. "Sipas tyre, ne nuk duhet ta kemi besën dhe ne jemi njerëz jo të duhur. Çështjet e ngritura nga mbrojtja kundër prokurorisë lidhen me deklarata jo të sakta lidhur me kohëzgjatjen e procedurave për periudhën paraprake dhe shanset e liritimit

paraprak. Prokuroria e ka keqorientuar gjykatën në shumë mënyra. Prokuroria ka orkestruar takimin e ambasadorëve evropianë në lidhje me të akuzuarit. Kemi pasur zhvillime të tmerrshme sa i përket sjelljes së prokurorisë. Është një shok dhe tronditje se si prokuroria është lejuar të sillt në këtë mënyrë. Të thuash se unë jam një person që do të kryej krim në përgatitjen e mbrojtjes është e turpshme. Ky është një shembull se si prokuroria ka humbur çdo arsye dhe logjikë dhe është e dëshpëruar", ka thënë Emmersoni.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi gjenden në paraburgim në Hagë nga 5 nëntori i vitit 2020. Qysh në fillim të këtij procesi gjyqësor ata janë deklaruar të pafajshëm nga të gjitha pikat e aktakuzës. Përpos Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, në Gjykatën Speciale gjenden edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.

Haxhiu paralajmëron vizitë në Hagë: Lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë

PRISHTINË, 23 MARS (ER) - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka paralajmëruar një vizitë në Hagë për t'i takuar ish-krerët e shtetit. Ajo ka bërë me dije të mërkurën se bashkë me

të do të jenë edhe një anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci. "Në fund të këtij muaji unë bashkë me një anëtar të Komisionit për

Legjislacion, kryetarin Saranda Bogujevci, kemi planifikuar një vizitë në Hagë. Si Ministri e Drejtësisë e kemi obligim që të bëjmë kërkesa për të gjithë. Sa i përket luftës së UÇK-së kemi

një qëndrim. Lufta ka qenë e drejtë për çlirim. Problemet e pasluftës politike me ta nuk më bëjnë mua që mos të kërkoj një takim me ta", ka thënë Haxhiu.



Lufta në Ukrainë ngadalëson edhe ekonominë e Kosovës



PRISHTINË, 23 MARS - Rritja e inflacionit dhe rënia e standardit jetësor do të jenë vetëm disa nga pasojat e luftës në Ukrainë, që do t'i arrijnë edhe qytetarët e Kosovës, thotë profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj. Sipas tij, Kosova do të jetë në mesin e atyre vendeve që do të kenë vështirësi më të mëdha ekonomike në krahasim me vendet më të zhvilluara. "Vendet që kanë nivel të zhvillimit dhe kanë bilanc të qëndrueshëm, e kalojnë më lehtë këtë proces. Ndërsa në vendet që kanë raport tregtar negativ, siç është rasti i Kosovës, padyshim që konsekuencat e zhvillimeve ekonomike botërore dhe rajonale janë më të rënda", thotë Ramosaj për "Radion Evropa e Lirë".

Deficiti i lartë tregtar, prej vitesh, përbën sfidë të madhe për Kosovën, e cila është importuese e pothuajse të gjitha produkteve. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, importi i mallrave në janar të këtij viti ka kapur vlerën e 338.1 milionë eurove, ndërsa eksporti ka qenë

në vlerë prej 64.2 milionë eurosh.

BQK-ja: Rritja ekonomike, nga 10.5 në 3.3 për qind

Si pasojë e luftës në Ukrainë, ekonomia e Kosovës do të pësojë ngadalësim të aktivitetit, tregojnë edhe projektionet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Sipas tyre, rritja ekonomike do të ngadalësohet në rreth 3.3 për qind këtë vit, nga 10.5 për qind sa ka qenë në vitin 2021. "Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike. Ndikimi i kësaj krize pritet të reflektohet në rritje të mëtejme potenciale të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit, me efekte negative në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë blerëse", thuhet në një raport të BQK-së të publikuar më 21 mars. Trazirat në tregje që i ka shkaktuar pushtimi i Ukrainës nga Rusia kanë rritur në veçanti çmimet e energjisë, naftës dhe gazit.

Evropa gati 40 për qind të furnizimeve me gaz i merr nga Rusia.

Rusia dhe Ukraina së bashku përbëjnë rreth 30 për qind të eksporteve të grurit në botë. Ukraina, po ashtu, është një nga prodhueset më të mëdha të hekurit. Ditë më parë është raportuar se një nga fabrikat më të mëdha në Evropë të hekurit dhe çelikut, e cila ndodhet në qytetin Mariupol të Ukrainës, është shkatërruar.

Profesori i Ekonomisë në Universitetin e Mitrovicës, Isa Tahiri, thotë se këto zhvillime do të ndikojnë edhe në furnizimin e Kosovës me hekur e çelik. "Është lidhje zinxhirore, e cila do të ndikojë në ngritjen e çmimit të armaturës që përdoret për ndërtim. Kosova është në ndërtim e sipër dhe kjo do të ndikojë në ndaljen e hovit të ndërtimeve të larta. Ndalja e hovit të ndërtimit krijon papunësi", thotë Tahiri. Shoqata e Ndërtimtarëve e Kosovës ka raportuar tashmë vonesa dhe mungesa të furnizimit me materiale ndërtimore. Sipas kësaj shoqate, materialet

ndërtimore janë shtrenjtuar për më shumë se 20 për qind qëkur ka nisur lufta në Ukrainë më 24 shkurt.

Hapat e qeverisë përballë vështirësive ekonomike

Për t'i zbutur efektet negative të luftës në ekonominë e Kosovës, Tahiri thotë se qeveria duhet të ndërhyjë me uljen e akcizës - që është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, si ato energjetike, duhani apo alkooli - dhe të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh), si dhe t'i subvencionojë prodhuesit vendorë. "Kosova urgjentisht duhet ta subvencionojë sektorin e bujqësisë. Nëse nuk mund ta arrijmë hapin këtë vit, së paku t'i rritim kapacitetet prodhuese për grurin, pemët dhe perimet për vitin tjetër", thotë Tahiri.

Më 9 mars Qeveria e Kosovës ka ndarë 50 milionë euro për subvencionimin e sektorit të bujqësisë. Vetëm për subvencionimin e grurit janë ndarë 474 euro për hektar. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës,

nëse kriza gjeopolitike nuk përmbyllet shpejt dhe shkalla e inflacionit vazhdon të rritet, perspektiva ekonomike për Kosovën do të jetë më pesimiste në krahasim me pritjet e tanishme.

Në shkurt të këtij viti inflacioni në Kosovë ka arritur në 7.5 për qind, krahasuar me 0.7 për qind sa ka qenë në shkurt të vitit 2021. Kosova, si shumë vende të tjera të botës, është përballur me rritje çmimesh edhe para shpërthimit të luftës në Ukrainë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit.

Më 11 mars Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO) ka paralajmëruar për rritje të mëtejshme të çmimeve - deri në 20 për qind - si pasojë e luftës në Ukrainë.

FAO ka thënë se Ukraina vështirë se do të mund ta korrë grurin këtë sezon, ndërsa marrja e produkteve nga Rusia është bërë më e vështirë, pasi bizneset nuk duan të rrezikojnë të bien ndesh me sanksionet që ka ky shtet.

BQK-ja dhe BERZh-i vazhdojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 23 MARS (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe

Zhvillim (BERZh), të kryesuar nga drejtori për Kosovë, Neil Taylor. Guvernatori Mehmeti ka falënderuar përfaqësuesit e BERZh-it për prezantimin e raportit të tranzicionit për vitin 2021/2022, duke theksuar

edhe angazhimin dhe kontributin e rëndësishëm që BERZh-i në vazhdimësi ka dhënë për mbështetjen e institucioneve të Kosovës, në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të vendit.



S'mjafton tërheqja nga Ukraina



Nga Bing WEST "Wall Street Journal"

Në janarin e vitit 1943, presidenti amerikan Frenklin Ruzvelt takoi në Kazablanka të Marokut kryeministrin britanik Uinston Çerçill. Në takimin midis tyre, u ra dakord që qëllimi i luftës të ishte dorëzimi i pakushtëzuar i Gjermanisë naziste.

Presidenti amerikan Xho Bajden takohet këtë javë me udhëheqësit e NATO-s në Bruksel. Objektiv i tij me vendosjen e sanksioneve ta ashpra ndaj Ruisë, ishte të pengonte pushtimin ukrainës. Por kjo gjë dështoi. Atëherë, cili duhet të jetë tani objektivi i zotit Bajden?

Samiti i NATO-s është mjedisi ideal për ta shpallur atë. Bajden dhe presidenti i Ukrainës Volodimir Zelenski kanë objektiva

të ndryshëm. Ukraina po lufton e vetme, pasi NATO e ka refuzuar anëtarësimin e këtij vendi. Është e kuptueshme, që nëse Ukraina t'i bindë rusët të largohen, ajo duhet të pranojë një lloj neutraliteti.

Objektivi i Zelenskit është t'i japë fund shkatërrimit të vendit të tij, por duke ruajtur lirinë e tij. Ndërkohë objektivi i Bajden duhet të jetë më i gjerë. Vladimir Putin e ka sfiduar hapur Amerikën si mbrojtëse e demokracisë dhe e vlerave perëndimore. NATO po ofron ndihmë për Ukrainën, brenda kufizimeve të tmerrshme. Pasi Putin kërcënoi me armët e tij bërthamore, Bajden ndaloi transferimin e avionë polakë MiG-29 në Ukrainë për t'u përdorur nga pilotët ukrainas. Presidenti tha se dhënia e këtyre avionëve, do ta përshkallëzonte konfliktin. Është e qartë se administrata Bajden do të që shmangë rreziqet

më të mëdha. Ndërkohë imazhet satelitore tregojnë anijet luftarake ruse të mbledhura rreth Odesës. Këto janë objektiva janë të kuptueshme. Por në listën e armatimeve me të cilat është furnizuar Ukraina, mungojnë raketat kundër anijeve.

Presidenti Bajden e ka quajtur Putinin një "kriminel lufte". Nga burimet ukrainase të inteligjencës dhe përgjimit e komunikimit, ka shumë të ngjarë që administrata Bajden dhe NATO të dinë emrat e të gjithë gjeneralëve rusë në Ukrainë dhe të komandantëve të njësisve të akuzuara për krime lufte.

E megjithatë, administrata nuk i ka përmendur ata publikisht, dhe nuk ka vendosur ndalimin e udhëtimit të tyre në Perëndim. Kur Iraku pushtoi Kuvajtin në vitin 1990, presidenti Xhorxh H.Ë. Bush deklaroi: "Kjo nuk do të zgjasë

shumë". Sot mungon një deklaratë e tillë e fortë nga ana e Bajden.

Pse kjo sjellje kaq e ndrojtur? Në vitin 1991 forcat amerikane e dëbuan lehtësisht ushtrinë irakiane nga Kuvajti. Ky opsion as që konsiderohet sot, pasi Rusia ka armë bërthamore. Një nga leksionet më shqetësuese të luftës aktuale, është se pasja e armëve bërthamore e rrit pritshmërinë e një agresori për të sulmuar me forca konvencionale.

Në çdo sulm të supozuar kundër Tajvanit, Xi Jinping ka të ngjarë të kërcënojë me përdorimin e armëve bërthamore, për ta penguar SHBA-në nga ndërhyrja me forcat e saj konvencionale. Nëse Putin do të dalë i paprekur nga kjo luftë, kjo do të përbente një precedent të tmerrshëm.


Nëse tërhiqen trupat rusen nga Ukraina, dhe Putin është ende në

krye të Ruisë, kjo do të jetë një humbje e rëndë për Amerikën. Në takimin e tij me liderët e 30 vendeve anëtare të NATO-s, Bajden duhet të kapërcejë "Rubikonin" e tij. Ai duhet të deklarojë prerë se sanksionet që po e gjymtojnë ekonominë ruse do të mbeten në fuqi të plotë, pa asnjë lloj zbutjeje, për sa kohë që në pushtet do të jetë Putin.

Objektivi i Amerikës nuk është rikthimi tek statuskuoja e vjetër. SHBA-ja kërkon largimin e Putinit në mënyrë që të përforcohet, ose ndoshta të rivendoset, roli i Amerikës si mbrojtëse e lirisë. Në rast se Bajden nuk e shpreh qartazi këtë objektiv në samitin e NATO në Bruksel kur bota është e tubuar rreth tij, ai nuk do ta bëjë këtë as në të ardhmen.

Shënim: Bing West, ish-ndihmës Sekretar i Mbrojtjes. Libri i tij i fundit titullohet "Toga e fundit: Një roman i luftës në Afganistan".





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Vokrri eliminohet nga gara, Ademi kandidati i vetëm për kryetar të FFK-së

Komisioni i veçantë brenda Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka aprovuar të mërkurën kandidaturën e Agim Ademit për kryetar të kësaj federate dhe e ka refuzuar atë të Gramoz Vokrrit. Refuzimi i kandidaturës së Vokrrit është bërë me arsyetimin se nuk i ka deponuar nënshkrimet e nevojshme për të qenë pjesë e garës më 6 prill, kur pritet të zgjedhet kryetari i FFK-së. Ndaj vendimit të këtij komisioni ka reaguar Vokri, i cili ka thënë se Ademi është i interesuar ta eliminojë me çdo kusht nga gara për kryetar të FFK-së

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 MARS - Gramoz Vokrri edhe zyrtarisht i është refuzuar aplikimi për kandidim për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). FFK-ja ka njoftuar të mërkurën se Agim Ademi do të jetë kandidati i vetëm për kryetar të kësaj federate në Kuvendin Zgjedhor, i cili pritet të mbahet më 6 prill të këtij viti. Komisioni i veçantë për mbarëvajtjen e procesit deri në datën e mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit të FFK-së ka kontestuar se refuzimi i aplikimit të Vokrrit ka ardhur si pasojë e parregullsisë në nënshkrimet e delegatëve që i ka mbledhur ai. Bëhet fjalë për nënshkrimet që kanë ardhur nga FC Prishtina, Ulpiana dhe KF Kika. "Komisioni, pas verifikimit të nënshkrimeve të delegatëve të

Kuvendit të FFK-së, ka konstatuar se në mbështetje të Agim Ademit për kryetar të FFK-së janë gjithsej 43 nënshkrime të vlefshme të delegatëve të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, kurse vetëm nënshkrimi i delegatit Naim Biçkaj nga KF Kika në Kuvendin e FFK-së është i pavlefshëm. Në nenin 30, paragrafi 4, dhe në nenin 39 të Statutit të FFK-së, parashihet: "Secili kandidat për kryetar të FFK-së duhet të jetë i mbështetur me nënshkrimet e së paku 15 delegatëve ligjorë të FFK-së". Marrë për bazë faktet e konstatuara dhe duke u bazuar në këtë dispozitë statutare, Komisioni ka ardhur në përfundim se meqenëse në mbështetje të kandidatit Agim ademi për kryetar të FFK-së janë 43 nënshkrime të vlefshme, të cilat janë të afatshme, atëherë ky kandidat e plotëson këtë kusht statutar për të qenë kandidat për

kryetar të FFK-së", është thënë në vendimin e komisionit të FFK-së. Ndërsa për Gramoz Vokrrin komisioni i FFK-së ka vlerësuar se Vokri nuk plotësohen kushtet për të qenë kandidat për kryetar të kësaj federate pasi nuk i ka nënshkrimet e nevojshme për të qenë pjesë e garës më 6 prill. "Komisioni, pas verifikimit të nënshkrimeve të delegatëve të Kuvendit të FFK-së, ka konstatuar se në mbështetje të Gramoz Vokrrit për kryetar të FFK-së janë gjithsej 13 nënshkrime të vlefshme të delegatëve të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, kurse të pavlefshme janë pesë nënshkrime: nënshkrimi mbështetës i Naim Biçkajt, dy nënshkrime mbështetëse të Rahman Haradinut, nënshkrimi mbështetës i Artan Osmanit dhe nënshkrimi mbështetës i Bujar Shabanit. Marrë për bazë faktet e vërtetuara dhe në kuptim të



dispozitës stutare nga neni 30, paragrafi 4, në nenin 39 të Statutit të FFK-së, komisioni ka ardhur në përfundim se meqenëse në mbështetje të kandidatit Gramoz Vokri për kryetar të FFK-së janë 13 nënshkrime të vlefshme, të cila nuk janë të mjaftueshme dhe janë të pas afatshme, atëherë ky kandidat nuk i plotëson këto kushte statutare për të qenë kandidat për kryetar të FFK-së", është thënë në vendimin e komisionit të FFK-së.

Gramoz Vokri reagon pas eliminimit nga gara për kryetar të FFK-së

Pas vendimit të komisionit të FFK-së ka reaguar ashpër Gramoz Vokri. Ai ka thënë se një



vendim i tillë tregon se Agim Ademi është i interesuar ta eliminojë me çdo kusht nga gara për kryetar të FFK-së. "Komisioni fantom i 'pavarur' brenda FFK-së vendos t'i refuzojë nënshkrimet e deponuara. Një gjë të tillë e bën jashtë çdo afati dhe normë statutare. Kjo tregon qartë tendencën e kundërkandidatit për ta eliminuar me çdo kusht konkurrencën dhe frymën demokratike të këtij procesi. Në arsyetimin e FFK-së kontestohen nënshkrimet e Kikës, Ulpianës dhe Prishtinës. Të bashkangjitura keni faktet që dëshmojnë të kundërtën. Këto nënshkrime kanë emra, mbiemra dhe vendime nga klubet e tyre", ka shkruar Vokri në profilin e vet në "Facebook". Kujtojmë se Gramoz Vokri është djali i legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokri.

Kosova sot zhvillon miqësoren me Burkina Fason

"Dardanët" sot (e enjte) zhvillojnë miqësoren e parë të muajit mars ndaj Burkina Fasos, e cila pritet të jetë mjaft e veçantë për faktin se debutojnë përzgjedhësi Alain Gresse. Strategu francez në konferencë për medie ka bërë me dije se në dy miqësoret e këtij muaji do të angazhohen të gjithë futbollistët. Ndërsa kapiteni Amir Rrahmani ka thënë se këto miqësore shërbejnë për ndeshjet e qershorit

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën i kreu përgatitjet e fundit për miqësore ndaj Burkina Fasos, e cila zhvillohet sot (e enjte) në stadiumin "Fadil Vokri". Në konferencën për medie përzgjedhësi Alain Gresse, i cili do të debutojë në krye të "dardanëve", ka bërë me dije se motivi të futbollistët është shumë i madh dhe se do t'u jepet rasti të gjithëve të

angazhohen. "Në këto dy ndeshje do të tentojmë t'i angazhojmë të gjithë futbollistët. Këto ndeshje do të na shërbejnë për ndeshjet garuese që do t'i kemi në muajin qershor. E vlerësoj motivin dhe entuziazmin e lojtarëve për të luajtur. Ata kishin dëshirë të madhe për ta treguar veten. Kjo është mjaft e rëndësishme. Natyrisht mbetet punë për t'u bërë, sidomos në rastet kur e kemi posedimin dhe në punën pa top", ka thënë Gresse. Në konferencën për medie i pranishëm ishte edhe mbrojtësi

i Napolit, Amir Rrahmani, i cili ka deklaruar se miqësoret ndaj Burkina Fasos dhe Zvicrës janë parapërgatitje e mirë për ndeshjet e Ligës së Kombeve, të cilat do të zhvillohen në muajin qershor. "Jemi duke u përgatitur për ndeshjen me Burkina Fason për ta treguar atë që dëshiron trajneri. Pas kësaj ndeshjeje e kemi edhe atë me Zvicrën. Të dyja ndeshjet do të na ndihmojnë për ndeshjet e qershorit në Ligën e Kombeve. Do të jenë ndeshje të rëndësishme. Ta shohim se çka kërkon trajneri nga ne dhe që në



këto miqësore të perfeksionohemi për ndeshjet e qershorit", ka thënë Rrahmani. Për ndeshjen që zhvillohet sot ka folur edhe sulmuesi më i mirë i Kosovës, Vedat Muriqi. Pavarësisht se është ndeshje miqësore, sulmuesi që angazhohet te skuadra e Mallorcas pret rezultat pozitiv. "Jemi duke vazhduar punën tonë dhe do ta japim maksimumin si gjithmonë. Edhe pse nuk e njohim Burkina

Fason, pak a shumë kemi filluar ta njohim dhe t'i shohim pikat e tyre të dobëta dhe me forcën tonë besoj se do të arrijmë rezultat pozitiv. Shpresoj ta përdorim këtë periudhë të mirë. Kur kemi pasur serinë pozitive prej 13 ndeshjeve pa humbje kemi qenë sikur tash të gjithë në formë dhe shpresoj ta përdorim këtë moment të mirë dhe të arrijmë rezultate të mira. Trajneri i ri? Ne jemi futbollistë profesionistë dhe duhet ta zbatojmë teknikën dhe taktikën e tij. I urojmë mirëseardhje atij dhe shpresojmë që të kemi rezultate të mira së bashku me të", ka deklaruar Muriqi. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Burkina Fasos nis me fillim nga ora 18:00 dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokri" në Prishtinë.

Kosova U17 pëson humbje nga Gjermania U17

PRISHTINË, 23 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll në konkurrencën e vajzave ka pësuar humbje në ndeshjen hapëse të turneut kualifikues të rrethit të dytë për Evropianin 2022, që po organizohet nën organizimin e FFK-së. "Dardanët" e reja

nuk kanë arritur t'i rezistojnë Gjermanisë, duke pësuar në fund humbje me rezultat 4:0. Vashat "dardane" kanë arritur t'u bëjnë ballë rivaleve shumë më cilësore vetëm në pjesën e parë, pasi në pushim shkuan pa pësuar gol, falë edhe paraqitjes së

shkëlqyeshme të portieres Alma Demiri. Ndërkaq, në pjesën e dytë gjermanet ishin shumë më efikase, duke realizuar katër herë në portën dardane. Serinë e golave e hapi Jella Veit në minutën e 54-t. Katër minuta më vonë Maria Steiner realizoi për 2:0, derisa e njëjta lojtare

shënoi edhe në minutën e 69. Ndërkaq rezultatit përfundimtar e vendosi Paulina Platner në minutën e 77. Ndeshjen e radhës vajzat e drejtuara nga Kushtrim Munishi e zhvillojnë më 26 mars kundër Austrisë në stadiumin "Fadil Vokri" në orën 16:00.

Xhaka: Nuk më besohet se do të luaj ndaj ekipit që e dua, Kosovës

CYRIH, 23 MARS - Mesfushori nga Kosova, Granit Xhaka, ka folur për ndeshjen miqësore që do ta luajë ndaj Kosovës. Për Xhakën pritet të jetë një ndeshje e veçantë, pasi që pikërisht ndaj Kosovës do të

regjistrojë 100 paraqitje për Zvicrën. "Nuk ka rastësi në jetë. Ndeshja ime e 100 kundër Kosovës, kundër një skuadre që e dua. Është diçka e pabesueshme. Nuk mund ta besoj që jam në fushë kundër

Kosovës, më bën dy herë më shumë krenar, për të gjithë familjen, për veten time, për të gjithë, ta luaj ndeshjen time të 100 në kombëtare kundër Kosovës, mezi po e pres me padurim këtë lojë.

Do të kënaqem. Miqtë, familja do të jenë atje, pritet të jenë shumë shikues. Për mua duhet të jetë kënaqësi, po dua vetëm ta shijoj", u shpreh Xhaka. Zvicra do të luajë ndaj Kosovës më 29



Januzaj, pas ftesës nga Belgjika: Po ushtroj ekstra. Besoj në kapacitetin tim

BRUKSEL, 23 MARS - Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj u ftua nga Belgjika pas një kohe të gjatë. Ai beson se me ushtrimet ekstra që po i bën, është ngritur në një nivel më lartë. "Më është dashur të pres shumë kohë, por jam i kënaqur që jam kthyer në kombëtaren belge. Dhe shpresoj të luaj, sepse nuk ka asgjë që më pëlqen më shumë sesa të luaj futboll", ka thënë Januzaj. "Jam një prej lojtarëve më të vjetër të ftuar? Nuk ndihem veteran. Jam i bindur se vitet më të mira i kam ende përpara meje. Garimi dhe konkurrenca për mua nuk janë problem. Unë e di se çka mund të jap dhe besoj në kapacitetet e mia. Jam më i matur, më i pjekur dhe po ushtroj shumë më shumë se më parë. Madje po bëj edhe ushtrime ekstra me ndihmën e një trajnerit personal. Këto detaje të vogla e bëjnë një diferencë të madhe", ka



shtuar Januzaj. Si shumë futbollistëve të tjerë, edhe futbollistit nga Istogu do t'i skadojë kontrata më 30 qershor. Interesim për të kanë shfaqur dy klubet italiane, Napoli e Atalanta. Por, futbollisti i Real Sociedadit nuk e di ende të ardhmen e tij. "Në futboll ndodh gjithçka. Nuk mund të

them asgjë për të ardhmen time. Njerëzit thonë gjëra që nuk më interesojnë. Në këtë moment po mendoj për Real Sociedadin, por nuk i dihet kurrë. Raiola (menaxheri) është një tip kërkues, e njoh. Çdo vendim do ta marr së bashku me të dhe me familjen time", ka përfunduar Januzaj.

SHKURT

UEFA delegon gjyqtarët e Kosovës për ndeshjen Sllovaki - Irlandë Veriore (U21)

Gjyqtari me stemën e FIFA-s, Visar Kastrati, është caktuar në ndeshjen ndërkombëtare të UEFA-s për kualifikimet e Kampionatit Evropian U-21 ndërmjet Sllovakisë dhe Irlandës Veriore. Kjo ndeshje do të zhvillohet në "Stadion MSK Zilina" në Zilina të Sllovakisë më 25 mars. Kastrati do të ndihmohet nga asistentët Granit Hyseni dhe Elvis Bicaj dhe nga gjyqtari i katërt Dardan Çaka.

Bombardohet stadiumi i Shakhtarit në Ukrainë

Bombat dhe raketat ruse po vazhdojnë të bien në territorin ukrainas. Një ka përfunduar edhe në stadiumin e futbollit "Donbass Arena", shtëpi e dikurshme e ekipit Shakhtar Donetsk. Në fakt, ky klub nuk po luante në "Donbass Arena" që disa vjet pasi që nga lufta e kaluar në Ukrainë, në vitin 2014, ky territor ka rënë në duar të separatistëve rusë dhe ukrainasit nuk kishin më qasje aty. Klubi ukrainas kishte migruar në Kiev.

Interi nuk e shkarkon Inzaghin

Pavarësisht prej rezultateve të dobëta në javët e fundit, Interi merr vendimin që Simone Inzaghi do të vijojë që të jetë pjesë e skuadrës. Lajmi është dhënë nga mediet italiane. Drejtuesit e klubit e vlerësojnë se Inzaghi ka përmbushur çdo pritshmëri, pasi objektivi minimal ishte sigurimi i një vendi në Ligën e Kampionëve për sezonin tjetër. Gjithsesi tifozët zikaltër kërkojnë edhe mbrojtjen e titullit kampion. Klubi ka nisur që tani punën për projektimin e skuadrës së edicionit të ardhshëm edhe pse çdo llogari në Serinë A mbetet e hapur. Për momentin Milani ka 66 pikë, 3 më shumë se Napoli i vendit të dytë dhe 6 nga Interi i vendit të tretë.

Juve bën gati një superofertë për Salahun

Juventusi po përgatitet të bëjë një lëvizje të madhe në afatin kalimtar të verës. "Zonja e Vjetër" ka kthyer sytë kah ylli i Liverpoolit, Mohamed Salah, i cili mund të largohet nga "Anfield" gjatë kësaj vere. "Gazzetta dello Sport" bën me dije se klubi nga Torino është gati të paguajë një shumë të konsiderueshme parash për egjiptianin. Salah ka kërkuar një pagë marramendëse te Liverpooli, e "Reds"-i duket se nuk është gati ta prishë strukturën e pagave në klub. Edhe Barcelona është duke ndjekur me vëmendje situatën e Salahut.

Hazardi nuk ka luajtur asnjëherë në 'El Clasico', largimi është i pashmangshëm

Eden Hazard është i zhgënjyer te Real Madridi. Mesfushori nuk ka hyrë në fushë në ndeshjen e javës së 29 të La Ligës kundër Barcelonës (0:4). Ai nuk ka luajtur në asnjë nga shtatë "El Clasico"-t qëkur iu bashkua Real Madridit nga Chelsea në vitin 2019. Hera e fundit që belgu hyri në fushë ishte pak më shumë se një muaj më parë, kur ai luajti 6 minuta në ndeshjen e javës së 25-të të La Ligës kundër Alaves, të fituar 3-0. Real Madridi dëshiron të ndahet me Hazardin verën e ardhshme. Me shumë mundësi ai do të shkojë në huazim dhe Madridi do t'i paguajë një pjesë të pagës. 31-vjeçari ka luajtur në vetëm 22 ndeshje për Real Madridin në të gjitha kompeticionet këtë sezon, duke shënuar 1 gol dhe duke dhënë 2 asistime.

Barty lë tenis në moshën 25 vjeçe

IPSWICH, 23 MARS - Lajmërim i bujshëm i Ash Bartyt, numrit një në botë të tenisit femëror. Në moshën 25 vjeçe tërhiqet, më pak se dy muaj nga triumfi në "Australian Open", në atdheun e saj. Me zërin që nuk i fshihet emocionet, Barty njoftoi për vendimin nëpërmjet një videoje prej gjashtë minutash të publikuar në "Instagram". "Është koha për të ndjekur ëndrra të tjera. Nuk do të ndalem së dashuruar kurrë tenis. Do të jetë gjithmonë pjesë e rëndësishme e jetës sime, por tani mendoj se është e rëndësishme ta shijoj fazën e ardhshme të jetës, si njeri, jo si sportiste", ka thënë Barty. Gjatë një bashkëbisedimi me shoqen e saj të skuadrës, Casey Dellaqua, Barty ka shtuar: "Është hera e parë që e them me zë të lartë dhe e kam të vështirë. Nuk kam më shtysën fizike, dëshirën emotive dhe gjithçka duhet për ta sfiduar veten në nivelet maksimale. Jam e lodhur". Kjo nuk është hera e parë që Barty lë



tenisin. Kampione e botës për të reja në "Wimbledon", në moshën 15 vjeçe në 2011, u largua nga aktiviteti për dy vjet më 2014, e lodhur nga presioni dhe nga udhëtimet e shpeshta që kërkon ky sport. Luajti kriket profesionist në Australi, pastaj në fund mori sërish në dorë raketën për t'iu rikthyer tenisit. Fitoi "Roland Garros" më 2019, Wimbledonin dhe pastaj, në janar, "Australian Open", duke u bërë e para lojtare e këtij vendi që fiton trofenë pas plot

44 vjetësh që nga triumfi i Evonne Goolagong. Në 12 vjet si profesioniste, fitoi 15 trofe individuale dhe 12 në tenis dsh. Ka qenë për 121 javë numri 1 i klasifikimit. Barty vjen pas 25 suksesesh në 26 ndeshjet e fundit të luajtura dhe ka fituar 3 nga turnetë e fundit në të cilët ka marrë pjesë. Vetëm një femër ka braktisur më parë tenis, në krye të klasifikimit WTA. Justine Henin ishte numri 1 kur u tërhoq në maj të vitit 2008.

Pogba paralajmëron largimin nga Unitedi

Mesfushori Paul Pogba duket i pakënaqur te Manchester Unitedi. Në një intervistë për "Le Figaro", ai shprehu me sinqeritet situatën e tij tek Unitedi. "Unë luaj në kombëtare dhe e di rolin tim. Ndiej

besimin e trajnerit, të bashkëlojtarëve dhe në krahasim me Manchester Unitedin është komplet gjë tjetër. Atje unë ndryshoj shpesh pozicionin dhe është e vështirë për mua të kem

ecuri. Atje ndryshon shpesh edhe sistemi i lojës, nuk ka një modul bazë. Unë shkoj mirë me trajnerin, por a kam vërtet unë një rol te Manchester Unitedi? E bëj shpesh këtë pyetje me veten, por nuk kam

përgjigje. Të jem i sinqertë, pesë sezonet e fundit nuk më kënaqin. Këtë sezon nuk do të fitojmë asgjë. Unë jam një person që punoj fort dhe për këtë gjë dua të shpërblehem me trofe, jo më me para", ka thënë Pogba.

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
 FERIZAJ
 Nr. 43 Data 22.03.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.
FERIZAJ

Në bazë të nenit 17 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenit 14 të statutit, Bordi i Drejtorëve i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A Ferizaj në mbledhjen e mbajtur me datën 14.03.2022, vendosi që me datë 22.03.2022 të shpall këtë:

KONKURS

Për vendet e lira të punës:

1. Zv. Kryeshef Ekzekutiv

Kualifikimi dhe përqaaditja profesionale për pozitën e punës: zv. Kryeshef Ekzekutiv

- Kandidati duhet të ketë përgaditje universitare – dhe përvojë pune menaxheriale.

Dertyrat dhe përgjegjësitë

- Në bashkëpunim me KE përcjell realizimin e Planit të Biznesit
- Ndihmon KE në organizimin e punëve të shërbimeve të caktuara
- Angazhohet në koordinimin e punëve të departamenteve të kompanisë.
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj, Statut dhe Regullore të kompanisë

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-në
- Dëshmi për kualifikimin profesional
- Certifikata e lindjes apo Ekstrakti/ jo më 1 vjetër se 6 muaj
- Leternjoftimi kopje
- Dëshmi mbi përvojën e punës përkatëse
- Vërtetimi nga Gjykata se nuk ushtrohet procedure hetimore jo më e vjetër se 6 muaj.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, dokumentacioni dorëzohet në zyrën e NPL "Stacionit të Autobusëve" SH.A Ferizaj, rr. Ahmet Kaqiku pa numër, nga ora 8:00 – 16:00.

Kryeshefi Bordit të Drejtorëve
Albrim Bytyri

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Muharrem Pllana nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Ardian Nokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Almir Lubja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u. "Yll Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merrret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
(Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

